TRIBUNA SINDIKALE

Janar 2009

Dhe drit' e diturisë
përpara do na shpjerë





Editorial

NDAL NDERHYRJEVE TE PUNEDHENESIT NE VEPRIMTARINE E SINDIKATAVE

Sindikatat Qendrore te Arsimit, FSASH dhe SPASH, nenshkruese te Kontrates Kolektive te Punes te nivelit te pare me Ministrin e Arsimit dhe Shkences, prej shume vitesh kane konfirmuar personalitetin e tyre si partner social serioz, objektiv e te pergjegjshem, si per mbrojtjen e interesave sociale - ekonomike te mesuesve, ashtu edhe per reformimin dhe modernizimin e sistemit arsimor ne vendin tone.

Midis dy partnereve, Sindikatave te Arsimit nga njera ane, dhe MASH nga ana tjeter, tashme jane vendosur dhe institucionalizuar marredhenie normale pune, dialogu e bashkepunimi. Keto marredhenie kane ardhur gjithenje duke u persosur, duke u bere me efektive, me te qendrueshme dhe me rezultative. Duke perjashtuar disa te meta ose mangesi, sidomos ne nivelin e dyte, mund te themi se marredheniet e partneritetit social midis punedhenesit dhe punemarresit ne sektorin e arsimit, tashme jane shembull per cdo sindikate tjeter profesioni ne vendin tone.

Ndersa ne nivel qendror, por ne shumicen e rasteve edhe ne nivel qarku apo rrethi, nga te dy palet ka vullnet dhe veprimtari konkrete korrekte per t'i mbajtur e zhvilluar keto marredhenie nga pozita ligjore e kontraktuale te drejta, **aty ketu, nga individe me cilesine e drejtorit te Zyres Arsimore, si punedhenes, te drejtorit apo zevendes-drejtorit te shkolles, si perfaqesues te punedhenesit, te ndikuar nga pozita partiake ose metoda te vjetruara e te tejkaluara drejtimi, tentohet dhe nderhyhet ne punet e sindikates per ta nenshtruar dhe per ta vene ate ne sherbim te tyre.** Natyrisht, eshte e tepert ta theksojme se ne keto raste jemi perpara shkeljeve te renda ligjore dhe kontraktuale.

Rastet me flagrante jane kur disa drejtore shkollash ose zevendesdrejtore, sic ka ndodhur shpesh here, marrin persiper hartimin e listave te anetareve te sindikates, duke ia dhene listen e bardhe "nje mesuesi te besuar", i cili ben kujdes t'u thote mesuesve se kjo eshte deshire dhe porosi e drejtorit. Ka raste kur "drejtues" te tille kane ndeshur ne kundershtimin e vendosur te mesuesve ose aktivisteve sindikale, por ka edhe raste kur, si rezultat i presionit qe kane ushtruar, u ka ecur…

Ne raste te tjera, ndonje drejtor zyre arsimore eshte perpjekur te beje presion per te penguar anetaresimin ne sindikate, duke ushtruar kontroll mbi listat emrore te anetareve te sindikates, me pretekstin se kjo eshte kompetence e tij. Drejtues te tille kane arritur deri atje sa, ne kundershtim te hapur me Kodin e Punes dhe Kontraten Kolektive te Punes te nivelit te pare, te transferojne ose largojne nga puna drejtues te seksioneve sindikale ne rrethe ose kryetar te keshillave sindikale ne shkolla.

Ne keto raste FSASH dhe SPASH kane nderhyre me vendomeri dhe nepermjet MASH eshte rivendosur e drejta e shkelur e sindikalisteve. Por, duke qene se akoma ndeshemi me veprime te drejtuesve ne dem te sindikatave e te sindikalisteve, ne e konsiderojme per detyre t'u drejtohemi atyre me autoritetin e Ligjit dhe te Kontrates Kolektive te Punes dhe t'u kujtojme se: Ligji nr. 7961 date 12.07.1995 (i ndryshuar) , per " Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise, ne nenin 202, pika 1 thote shprehimisht: "Shkelja e neneve…181, 184-186 te parashikuar ne kete Kod denohen me gjobe deri ne 50 fishin e pages minimale mujore…ndersa pika 7 thote se "Shkeljet e dispozitave te ketij Kodi, kur perbejne veper penale, denohen sipas dispozitave te Kodit Penal".

Duke iu kujtuar ketyre shkelesve qe te lexojne permbajtjen e neneve 181, 184,185 dhe 186 te Kodit te Punes, po evidentojme ketu vetem disa paragrafe te ketyre neneve:

1) Ndalohet cdo akt nderhyrjeje ne krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave sindikale nga organet shtetrore. (Neni 184)

1)Konsiderohen si nderhyrje te punedhenesit masat qe:

a) nxisin krijimin e organizatave te punemarresve qe mbizoterohen nga nje pundhenes, qe mbeshtetin organizata punemarresish me mjete financiare apo me menyra te tjera, me qellim qe t'i vendosin keto organizata nen kontrollin e tyre.

b) pengojne krijimin, funksionimin ose administrimin e nje organizate punemarrsish (sindikale),

c) demtojne punemarrsin per shkak te perkatesise ose veprimtarise se tij sindikale, duke e diskriminuar ate (Neni 186).

PERMBAJTJA

- *Editorial:* Editorial: Ndal nderhyrjeve te punedhenesit ne veprimtarine e sindikatave 2
- Detyra te reja, ne zbatim te Projektit me FNV/AOb 3
- Bashkepunim i frytshem i seksioneve te SPASH dhe FSASH ne Korçe 4
- Nga jeta sindikale e FSASH dhe SPASH 6
- Organizimi "Ores se lire" kerkon pune krijuese nga çdo mesues 9
- Tregues te trajnimit te personelit arsimor gjate vitit 2008 11
- Nje pervjetor i shenuar i Gjimnazit te Tiranes 13
- Te reja shkencore dhe keshilla praktike 15

Kopertina e pare:
Pamje nga shkolla 9-Vjecare "Neim Babameto", Durres
Kopertina e fundit:
Veprimtari edukuese kulturore te nxenesve ne shkollen 9-Vjecare "Asdreni", Korce, ne kuadrin e elimimit te punes e femijeve

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 39
Janar 2009
Botim i FSASH dhe SPASH
Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV

ADRESA :
Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe Fakultetit Juridik,Kati i 3-te, Tirane
Tel & Fax + 355 4 225 65 32
Celular: + 355 68 20 34 674,
+ 355 69 22 69 795, + 355 68 21 52 891
E-mail: fsash@abcom-al.com
Internet: www.fsash-spash.com

Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, Kryeredaktor

Detyra te reja ne zbatim te Projektit me FNV/AOb

Sindikatat e arsimit, FSASH dhe SPASH, ndodhen perpara detyrash te medha per perfaqesimin dhe mbrojtjen e interesave social - ekonomike te anetareve, por edhe per ngritjen e metejshme profesionale te mesuesve dhe zhvillimin e sistemit arsimor ne vendin tone.

Te gjitha keto detyra gershetohen dhe mbeshteten edhe nga aktivitetet e shumta qe organizohen ne kuadrin e Projektit qe ato jane duke zbatuar ne bashkepunim me sindikatat holandeze FNV dhe AOb.

Eshte i rendesishem fakti qe aktivitetet dhe objektivat e Projektit jane pothuajse te njejta me drejtimet kryesore te punes se vete sindikatave, sic jane konsolidimi i keshillave sindikale ne shkolla dhe seksioneve sindikale ne rrethe, rritja e numrit te anetareve, duke i kushtuar kujdes te vecante mesuesve te rinj dhe grave mesuese, permiresimit te gjendjes financiare, nepermjet rritjes se te ardhurave nga kuotizacioni, informimit me te mire te anetareve, nepermjet Revistes dhe faqes se internetit etj. Ne kete kuader, nje vend te vecante zene aktivitetet per kualifikimin sindikal e profesional te mesuesve, per parandfalimin dhe eliminimin e punes se femijeve etj.



Keta muajet e pare te vitit 2009 jane edhe me te rendesishem per sindikatat tona edhe per faktin se jane ne pergatitje e siper dhe do te organizohen disa aktivitete permbyllese te ketij Projekti, ne te cilat do te behet analiza e realizimit te objektivave te caktuara, arritjeve, problemeve dhe do te percaktohen drejtimet kryesore te punes sone ne vijim.

Keshtu, ne fund te janarit organizohet seminari mbi pjesemarrjen e grave mesuese ne sindikate, ne fund te shkurtit organizohet Tryeza e Rrumbullkate mbi angazhimin e sindikatave dhe aktoreve te tjere per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, ne mars organizohet Tryeza mbi sigurimin e me shume sherbimeve per anetaret e FSASH e SPASH, ndersa ne muajin prill organizohet konferenca permbyllese e ketyre aktiviteteve

Ne keto kushte, eshte shume e rendesishme qe, duke filluar nga seminari me pjesemarrjen e grave drejtuese lokale, te mbahen mire parasysh planet e veprimit, me qellim qe rezultatet e arritura te cohen me perpara dhe, ne kete kuader, te caktohen objektiva te reja, te cilat te ndiqen per zbatim nga ana e seksioneve sindikale gjate ketij viti e ne vazhdim.

Eshte fakt qe puna e bere nga te dyja sindikatat ka cuar ne riorganizimin e disa seksioneve, sidomos ne rrethet Berat, Gramsh, Sarande, Bulqize, Tropoje etj, dhe ne konsolidimin e disa te tjereve, si ne rrethet Tirane, Vlore, Fier, Shkoder, Korce, Kucove, Skrapar, Mallakster, Librazhd etj, shoqeruar kjo edhe me rritjen e numrit te anetareve te te dyja sindikatave, nje pjese e mire e te cileve jane nga radhet e grave mesuese.

Rritja e numrit te anetareve dhe fuqizimi i metejshem i sindikatave jane te lidhura drejtperdrejt edhe me shtimin e sherbimeve qe sindikatat ofrojne per anetaret e tyre, gje qe perben nje objekt te rendesishem te aktivitetit te perditshem te sindikatave tona, por qe do te jete objekt diskutimi edhe ne Tryezen qe do te organizohet ne mars, me pjesemarrjen e drejtuesve lokale te seksioneve, ku pritet te behet edhe nje bilanc i punes se deritanishme dhe synimeve per kete vit, por edhe ne vijim, sipas planit te veprimeve qe do te diskutohet e miratohet ne kete Tryeze.

Dikutimet dhe analizat, sidomos ne lidhje me format qe mund te perdoren per te zgjeruar sherbimet ndaj anetareve, si motivimi i mesuesve per

Vijon në faqen 4

Vijon nga faqja 3

pune cilesore dhe rezultate te larta, mbrojtja ligjore, krijimi i lehtesirave ne pagesat e rasteve te semundjeve, realizimi i marrveshjeve per favorizime ne marrje kredish, forma me interes ne problemet e sigurimeve shoqerore, akte e marrveshje te tjera, dypaleshe e shumepaleshe, me banka, agjensi turistike, per sherbime plus ndaj anetareve, etj.

Angazhimi i mesuesve ne pune konkrete per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve eshte nje tregues tjeter i rendesishem i faktit qe sindikatat tona ndodhen tani ne nje faze tjeter me te larte te aktivitetit te tyre sindikal, duke mos u kufizuar vetem me mbrojtjen e drejtperdrejte social-ekonomike te mesuesve, por duke u marre edhe me ceshtje te rendesishme te zhvillimit te sistemit tone arsimor dhe te zhvillimit te shoqerise sone ne teresi.

Shembulli i shume shkollave, sidomos ne rrethet Tirane, (zona e Kamzes), Fier, Elbasan, Korce, Shkoder, Durres etj, do te evidentohet edhe me mire ne aktivitetet qe pritet te zhvillohen ne muajet e ardhshem, me pjesemarrjen, jo vetem te perfaqesuesve te sindikatave te arsimit, por edhe te atyre te sindikatave te degeve te tjera dhe te institucioneve e organizatave qe jane te angazhuara per eliminimin e punes se femijeve, si nje parakusht per zhvillimin e arsimit dhe progresin e shoqerise sone ne teresi.

Stavri LIKO

Bashkëpunimi i frytshëm i seksioneve të SPASH dhe FSASH në Korçë për shmangien e braktisjes së shkollës dhe eliminimin e punës së fëmijëve

Fryma e bashkëpunimit ndërmjet SPASH and FSASH, sidomos në kuadrin e zbatimit të projektit me sindikatat holandeze FNV/AOb, po reflektohet edhe tek seksionet e tyre në rrethin e Korcës. Sindikatat tona në bazë, kanë hyë tashmë në një fazë të re të rëndësishme, në veprimtarine e tyre, e cila ka nevojë të kuptohet drejt prej mësuesve sindikalistë dhe të mbështetet fuqishëm, sepse ajo po zgjeron sferën e ndikimit të saj, jo vetëm për mbrojtjen sindikale, por edhe për politikat arsimore të së ardhmes. Ky bashkëpunim po rrit kontaktet midis sindikalistëve, jo vetëm brenda një shkolle, por edhe midis shkollave në zona urbane e rurale, në shkallë rrethi e vendi. Bashkëpunimi i mirë i dy sindikatave për trajnimet e organizuara nga qendra ka sjellë në duart e sindikalistëve materiale me vlerë për punën me nxënësit në përgjithësi e sidomos me ata të quajtur "të vështirë", si edhe për atë që duhet bërë në familjet dhe komunitetin, DAR e pushtetin vendor dhe qeverinë e nxënësve.

Një punë të mirë kanë bërë dy sindikatat tona për realizimin me sukses të objektivave të caktuara në kuadrin e projekteve që SPASH dhe FSASH janë duke zbatuar në bashkëpunim me sindikatat holandeze FNV e AOb, Organizatën Ndërkombëtare të Arsimit, EI, dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë.

Aktivitete të larmishme dhe punë konkrete po organizojnë seksionet tona, sidomos në katër shkollat e rrethit tonë: "Asdreni" e "Naim Frashëri" në qytet dhe Pojan e Sheqeras në zonat rurale, për mbrojtjen e fëmijëve, shmangien e braktisjes së shkollës dhe eliminimin e punës së fëmijëve. Tendenca e braktisjes së shkollës dhe shfrytëzimi i krahut të lirë të punës së fëmijëve nga prindër e biznese të pandershëm tashmë janë të pranishme dhe përbëjnë shqetësim real për seksionet tona sindikale, puna e të cilave rezulton të jetë frytdhënëse.

Ky angazhim në rrethin tonë ka shërbyer për ngritjen e grupeve mbi bazë shkolle dhe trajnimi që iu bë sindikalistëve të zgjedhur hapi prespektiva të qarta për atë që do të bëhej më tej. E rëndësishme ishte faza e evidentimit në terren te nxënësve që kishin braktisur shkollën, te atyre që punonin dhe kontigjentit që mund ta braktisin atë nga dita në ditë. Shpërndarja e pyetësorëve tek mësuesit dhe plotësimi i tyre, duke kontaktuar drejtpërdrejt me nxënësit, evidentoi të dhëna që na vendosnin para detyrash më delikate. Para çdo grupi mësuesish, të intervistuarit shpalosën vehten dhe problemet e vështira që shoqërojnë familjet e tyre. Numri i nxënësve të evidentuar që në hapat e parë të punës ishte 104, me të cilat do të punonin, jo vetëm mësuesit e trajnuar, por edhe të tjerë, duke e zgjeruar kështu pjesmarrjen me elemente të rinj të grupeve të ndryshme shoqërore; shkollë-familje-komunitet.

Punë konkrete u bë në shkollat Sheqeras dhe Pojan, ndaj me mirënjohje falenderojmë mësuesit sindikalistë e të palodhur: Liljana Hysolli, Drita Lino, Servet Mustafa, Edmond Gjolli, Fatos Kello. 35 nxënës kishin braktisur mësimin në këto shkolla dhe rreth 40 të tjerë ishin

kontigjent për ta braktisur atë. Shumë të tjerë, në emër të ndihmës që duhej t'u jepnin familjeve, kryenin punë nga më të ndryshmet. Takimet më prindër, bisedat me ta dhe aktorë të tjerë të interesuar, do të mundësonin një klimë më të favorshme në punën e mësuesve drejtpërdrejt me nxënësit. Rezultatet ishin të mira. Në një kohë jo fort të gjatë, u tërhoqën në bankat e shkollës 15 nxënës dhe u shmang braktisja me 25 të tjerë.

Duket sikur puna jonë ka insistuar vetem në këto shkolla, duke lënë pas dore shkollat e qytetit, por kjo nuk qëndron, pasi rezultatet e punës edhe ne shkollat e tjera u panë shumë qartë në seminarin që u organizua ne Korcë, në prani edhe të ekspertëve holandezë Marten Kircz dhe Michael Kersten. Në seancën që u zhvillua në mjediset e shkollës "Asdreni" me të gjithë aktorët e interesuar dhe pjestarët e familjeve të nxënësve, si edhe shoqatës së romëve etj, u gershetuan diskutimet për punën e bërë, rezultatet e arritura dhe detyrat për të ardhmen me programin artistik të grupit të shkollës, që tregoi vlerësimin dhe përgjegjshmërinë e seksioneve tona ndaj realizimit me sukses të këtij aktiviteti. Vlen të përmendet puna e mirë e mesueseve sindikaliste si Martha Xharo, Zhani Mlloja, Zhani Suljoti. 22 ishte numri i nxënësve që kishin braktisur shkollën tek "Asdreni". Me ta punuan 7 mësues, anëtarë të dy sindikatave, të cilët duhen vlerësuar për faktin se nuk e patën të lehtë të tërhiqnin ne shkolle 5 prej tyre, duke mos u tërhequr edhe nga puna me të tjerët.

Ja se si shprehet një nxënëse e braktisur nga prindër të divorcuar dhe që jeton me gjyshen e saj, e cila kishte bërë një krijim që i dilte nga zemra e me lot në sy recitoi:

Kam dalë në rrugë
dhe lyp thërrime
I kam dy prindër
por jam jetime
Të gjithë luajnë e qeshin
dhe mua më përqeshin
Kur unë shkoj të luaj me ta
më thërrasin veç fukara
Nëna më lindi dhe më la
në rrugë të vetme pa vëlla
I lutem zotit të më ndihmojë
ose të më cojë ku të dojë.

Shkolla "Naim Frashëri" është shkolla me shkallë braktisje dhe rrezik më të lartë se gjithë të tjerat. Arsyet janë të shumta, sepse edhe kontigjenti i nxënësve të saj i përket komunitetit egjiptian dhe rom. Në këtë shkollë



problemet e punës së fëmijëve dhe braktisja janë shumë të mëdha, ndaj puna jonë mund të zgjidhë një pjesë të vogël të tyre. Këtu duhet të bashkëpunojmë me mire me pushtetin vendor e atë qendror, me politikat e tyre të punësimit apo karakterin social-ekonomik, ku vlen të përmendet për punë të mirë sindikalistja Zhani Papa.

Me shumë efektivitet ishin edhe aktivitetet që u zhvilluan në zonën minoritare Liqenas, në kuadin e një programi që SPASH dhe FSASH zabatuan me mbështetjen e EI/NOT, ku u përfshinë më shumë se 40 nxënës dhe 16 mësues të shkollave 9-vjeçare Liqenas e Goricë. Ky angazhim pati efekt pozitiv, sepse trokiti dhe u bë pjesë e familjeve me probleme ekonomike dhe u "kujtoi" prindërve se fëmijet duhen arsimuar dhe pse ana ekonomike nuk i favorizon.

Në këto aktivitete u angazhuan shumë mekanizma si Komuna, drejtorite e shkollave, DAR, mësues e prindër, qeverite e nxënësve, gjë që forcoi besimin për rezultate të mira me permirësimin e marrdhënieve midis nxënësve dhe mësuesve sindikalistë.

Ngritja e problemit nga stafi i mësuesve të dy sindikatave për tekstet, si edhe për aktivitetet me shkollat përtej kufirit dhe komunitetin shqiptar, bënë sensibilizimin e Ministrisë së Arsimit dhe DAR për zgjidhjen e tyre.

Periudha shtator-dhjetor 2008 për dy seksionet tona sindikale ishte periudhë e rifreskimit të të dhënave, pasi mbyllja e vitit arsimor 2008 ia la vendin vitit të ri shkollor. Po kështu para nesh dilte detyra e verifikimit të nxënësve që qëndruan larg bankave të shkollës, sa të tjerë vazhdojnë të shfrytëzohen në punë të vështira dhe sa të tjerë mund ta braktisin atë.

Tashmë kemi një traditë dhe një angazhim rezultativ, jo vetëm të mësuesve të dy sindikatave, por edhe të nxënësve e të komunitetit, gjë që na jep siguri për një punë rezultative edhe në të ardhmen.

Albina Pepo, SPASH
Hektor Fejzulla, FSASH

Nga jeta sindikale

FSASH PARA FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE TË REJA

Nga Xhafer Dobrushi
Kryetar i FSASH

Ne mbledhjen e nentorit te vitit te kaluar, Keshilli Drejtues i FSASH vendosi njezeri qe viti 2009 te jete vit zgjedhjesh ne te gjitha strukturat e Federates. Sipas ketij Vendimi fushta hapet ne muajin mars dhe, me 2-3 muaj nderprerje, shtrihet derin ne nentor. Zgjedhjet do te zhvillohen ne dy faza.

Faza e pare, ne pranevere, fillon nga muaji mars dhe shtrihet deri ne muajin maj. Ne kete faze behen analizat e veprimtarise sindikale dhe zgjedhjet ne keshillat dhe organizatat sindikale te bazes.

Faza e dyte, per shkak te zhvillimit te provimeve dhe te pushimeve verore, fillon ne muajin shtator dhe perfundon ne muajin nentor. Ne kete faze behen analizat e punes dhe zgjedhjet ne Seksionet Sindikale ne baze rrethi e qarku dhe mbahet Kongresi i Katert i FSASH.

Programi i veprimtarive dhe datat konkrete te zhvillimit te ketyre dy fazave do te miratohen ne mbledhjen e ardhshme te Keshillit Drejtues te FSASH, qe do te zhvillohet ne muajin shkurt.

Periudha per analizen e veprimtarise sindikale, per dhenie llogari dhe zgjedhje te reja perben nje nga momentet me te rendesishme ne jeten e Federates Sindikale te Arsimit dhe Shkences. Kjo sepse, ne kete rast nuk behet fjale per nje mbledhje dhe analize te zakonshme, te rendomte, sa per te kaluar radhen, por per nje proces verifikimi e ballafaqimi, per nje proces vleresimi real te asaj qe kemi bere ne keta 4-5 vjet dhe te percaktimit te synimeve dhe objektivave qe do te arrijme ne te ardhmen.

Pavaresisht nga koha kur zhvillohet nje faze apo nje tjeter e zgjedhjeve, cdo aspekt i tyre, duke filluar nga faza pergatitore e nivelit te pare e deri te Kongresi i Federates, nuk mund te merren te shkeputura. Te gjitha fazat dhe aspektet perberes te tyre jane te lidhur ngushte me njera tjetren dhe perbejne nje proces te vetem.

Qe ky proces te kurorezohet me sukses, per secilin nivel te zgjedhjeve, duke filluar nga keshillat dhe organizatat sindikale ne baze, rendesi te vecante ka **periudha pergatitore.** Nje keshill sindikal shkolle, fakulteti apo njesie tjeter ne baze, nje seksion sindikal rrethi apo qarku, nuk mund te mjaftohet vetem me caktimin e nje date per mbledhjen zgjedhore ne njesine sindikale ku vepron. Dita e zgjedhjeve vjen si finalizim i gjithe fushates disa mujore, pra i nje periudhe relativisht te gjate pergatitore. Kjo periudhe pergatitore perfshine veshtrime kritike, biseda te lira, takime, publikime, per ate qe ka bere sindikata ne keto vite, per problemet, shqetsimet dhe kerkesat me te cilat eshte ballafaquar dhe per menyren dhe nivelin e zgjidhjes se tyre, per nivelin e zhvillimit te dialogut social me punedhensin, per shtimin dhe konsolidimin e radheve te sindikates, etj. Sa me intensive, e larmishme dhe e gjalle te jete kjo faze, aq me shume mundesi ka sindikata ne baze, ne rreth apo ne qark per te percaktuar objektiva konkrete dhe mobilizues per te ardhmen.

Tashme eshte e njohur dhe e provuar se forca e nje sindikate qendron ne vitalitetin e strukturave te saj ne baze, ne aftesine e tyre vetvepruese, ne rritjen e kapaciteteve organizuese dhe drejtuese te ketyre strukturave. Ketu nuk eshte fjala per te shmangur pergjegjesine e strukturave me te larta, sic eshte Keshilli Drejtues, Kryesia dhe lidershipi i Federates. Perkundrazi, keto organizma vihen realisht para pergjegjesise, levizin me shpejt dhe me me efektivitet, kur strukturat ne baze jane me kerkuese ndaj tyre. Prandaj, nje nga objektivat kryesore qe duhet te pershkoje fushaten tone per zgjedhje te reja eshte dhe mbetet **funksionimi statutor i te gjithe strukturave te Federates.** Ne perberje te FSASH ka sot, jo vetem mjaft seksione sindikale, por edhe keshilla e organizata sindikale qe veprimtarine e tyre te vazhdueshme e zhvillojne pergjithesisht ne nivele qe kerkon Statuti i FSASH. Seksione rrethi apo qarku si dhe keshilla sindikale ne perberje te tyre, sic jane ato ne Qytetin e Tiranes, ne Qarkun e Vlores, ne Fier, Mallakaster, Skrapar, Permet, Kucove; deri diku edhe Durresi, Devolli, Dibra, Kurbini, Librazhdi, e ndonje tjeter, nga viti ne vit kane ardhur duke i rritur kapacitetet e tyre drejtuese, jane te vemendshem ndaj kerkesave dhe nevojave te anetareve, ndjekin ne vazhdimesi dhe luftojne, ne radhe te pare vete, per plotesimin e ketyre kerkesave. Jane pikerisht keto seksione qe negocojne me nivel e objektivitet me punedhesin dhe mbrojne me dinjitet interest e kerkesat e anetareve qe perfaqesojne.

Por, FSASH ka nevoje qe gjate kesaj fushate zgjedhore arritjet e ketyre seksioneve sindikale te konsolidohen me tej dhe pervoja e

tyre te ndikoje e ndihmoje qe ne kete nivel te ngrihen te gjithe seksionet e tjera sindikale me qellim qe te eliminojme gradualisht situatat e pasivitetit, te pritshmerise nga lart, te mungeses se forces realizuese, te pesimizmit, qe karakterizojne akoma mjaft seksione ne rrethe ose qarqe.

ne te gjithe keto aspekte. Nje drejtues sindikal, ne cdo nivel qofte, nuk mund ta justifikoje besimin e atyre qe e kane zgjedhur nese nuk eshte i afte te njohe ne imtesi proceset dhe kerkesat e reformimit te sistemit ku ai eshte punesuar, pra te arsimit, nese nuk ben perpjekje per t'u trajnuar e

madhe mesuesish sindikaliste per minimizimin e fenomenit te braktijes se shkolles , te nxjerrjes nga rreziku i braktisjes te nje numri te madh nxenesish, te eliminimit te punes se femijeve, te fenomenit te analfabetizmit, etj. Me rendesi eshte kujdesi qe ka treguar dhe rezultatet



Objektiv tjeter me rendesi i fushates zgjedhore duhet te jete **freskimi, riperteritja dhe edukimi i lidershipit te Federates ne te gjithe nivelet.** Zgjidhja e kerkesave ne rritje qe shtrohen para FSASH, si per mbrojtjen sociale ekonomike te kerkesave dhe interesave te anetareve ashtu edhe per t'u angazhuar e per te dhene ndihmese reale ne thellimin e reformimit te sistemit arsimor dhe modernizimin e tij, nuk mund te arrihen pa edukimin sindikal te lidershipit ne te gjitha nivelet. Funksionet sociale te sindikates ne arsim nuk mund te ushtrohen ne nivel cilesor nese ato nuk lidhen ngushte me permbajtjen e reformes dhe nevojen per ndryshim ne gjithe sistemin arsimor, nese Sindikata nuk ushtron ndikimin e saj

kualifikuar, nese nuk eshte aktiv dhe ne pararoje ne kolektivin arsimor ku ben pjese.

Fushata zgjedhore ne FSASH duhet te pershkohet nga kerkesat ne rritje per te zgjedhurit, nga krijimi i nje mjedisi qe te mbeshtese elementin e ri, sidomos grate dhe te rejat, qe te mundesoje seleksionimin demokratik te kandidateve, te inkurajoje e mbeshtese drejtuesit e afte dhe me vizion, qe te mos u japе hapesire atyre qe nuk kane ecur dhe nuk ecin me kohen, qe jane te vjetruar sidomos ne koncepte e praktika pune e drejtimi.

Fushata e zgjedhjeve te reja ne Federate duhet te fokusohet mire ne pervojat pozitive qe ka krijuar FSASH ne keto vitet e fundit, sidomos ne angazhimin e nje mase te

qe ka arritrur FSASH per te bashkerenduar trajnimin sindikal me trajnimin professional te mesuesve, per permbajtjen e oreve mesimore ekstrakurrikulare, per mbrotjen e te drejtave te femijeve nepermjet arsimimit, artit dhe medias, etj. FSASH ka dhene nje ndihmnese te ndjeshme ne hartimin e draftit te Kodit te Etikes se Mesuesit dhe po diskuton me MASH per hartimin e kritereve per emrimin e drejtuesve dhe mesuesve ne sistemin parauniversitar te arsimit.

Keto pervoja duhet te sherbejne per objektiva te reja dhe angazhim me te madh dhe me efektiv te te gjithe strukturave sindikale ne problemet jetike te arsimit dhe arsimimit te brezit te ri, si nje kusht per progresin shoqeror te te gjithe vendit.

2009, viti i zgjedhjeve ne strukturat sindikale dhe detyrave te rendesishme per SPASH

Me date 23 janar u mblodh Komiteti Ekzekutiv i SPASH-it, ku u diksutua ne lidhje me veprimtarine e SPASH-it per vitin 2009, mbeshtetur ne strategjine e percaktuar ne Kongres.

Strategjia e SPASH-it mbeshtet arsimin publik e privat dhe kerkesat per cilesi e barazi ne arsim, te mesuarit gjate gjithe jetes, pranon bashkepunimin me MASH, pushtetin lokal dhe OJQ-te per eleminimin e braktisjes se shkolles nga femijet,si dhe domosdoshmerine e nevojen e kualifikimit per rritjen e profesionalizmit bashkekohor te mesuesit.

SPASH e ka pranuar dhe e mbeshtet demokracine, por kerkon partneritet ne nivel qendror, lokal dhe ne nivel shkolle, per problemet sociale dhe te reformes arsimore, zbatimin e kontrates se nivelit te pare e te nivelit te dyte te nenshkruara me MASH, DAR dhe ZA ne rrethe. Roli i mesuesit ne nje shoqeri demokratike kerkon nje vleresim moral nga shoqeria, por njekohesisht edhe material nga shteti per punen e tij. Njekohesisht kerkese e vazhdueshme e sindikates ka qene dhe do te mbetet permiresimi i kushteve te punes per mesuesit dhe femijet ne shkolle, jo vetem nga pushteti qendror, por edhe nga pushteti lokal.

Realizimi ne vazhdimesi i veprimtarive ka konsoliduar strukturat e organizates.

Duke marre ne analize veprimtarite e zhvilluara gjate vitit 2008, si roli i gruas ne arsim e sindikate, sherbimet per anetare dhe drejtues, funksionimi i partneritetit me MASH, u vleresuan arritjet, por sindikatat u ndalen edhe ne te metat e mosarritjet qe u vune re gjate vitit 2008. Per kete arsye eshte parashikuar qe ne daten 22 maj Keshilli Kombetar te zhvilloje nje seminar vetem per kontraten kolektive dhe grupi i punes qe do te caktohet per te negocuar gjate 6 mujorit te dyte te vitit 2009, te kete te qarta kerkesat dhe mundesite, me qellim qe ato te realizohen ne kontraten e re kolektive qe do te nenshkruhet nga te dyja palet.

Sipas Statutit dhe kontrates kolektive te nivelit te pare, qe te funksionoje cilesisht mire, ku te kete edhe informacion te ndersjellte, jane parashikuar qe gjate vitit 2009 te zhvillohen kater mbledhje te Keshillit Kombetar dhe gjashte mbledhje te Komitetit Ekzekutiv.E gjitha kjo zhvillohet per nje veprimtari te zakonshme vjetore, ku u percaktuan edhe temat qe do te trajtohen.

Viti 2009 per SPASH eshte edhe viti i zgjedhjeve ne te gjitha strukturat e saj.

Dy ishin ceshtjet me te rendesishme ku u ndal Komiteti Ekzekutiv ne lidhje me fushaten e zgjedhjeve:

- Ndryshimet ne Statut, ne ato nene ku gjate periudhes 4-vjeçare ka patur veshtiresi ne funksionimin praktik ne strukturat e SPASH-it.

- Percaktimi i fazave te zgjedhjeve ne te gjitha strukturat e SPASH-it.

Zgjedhjet; do te zhvillohen ne tri etapa:

- Nga 6 shkurti deri me 11 prill, do te zhvillohen zgjedhjet ne te gjitha shkollat dhe kopshtet publike e private ne sistemin parauniversitar, ku funksionon SPASH.

- Nga 11 prilli deri me 22 maj, do te zhvillohen konferencat per zgjedhjen e krytareve e te strukturave drejtuese te SPA ne rrethe.

- Me 11-12 shtator 2009 do te zhvilloje punimet Kongresi i V-te i SPASH.

Analiza e buxhetit te SPASH-it per vitin 2008 dhe projektbuxheti per vitin 2009, paten shume diskutime ne mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv .Nga diskutimi i z.Bajram Kruja u vleresua puna e mire e bere gjate vitit 2008 ne 20 sindikata rrethesh ne drejtim te mbledhjes se kuotizacioneve me lista te rregullta te paraqitura prane DAR dhe ZA-ve, ku kuotat transferohen ne qender nepermjet bankes dhe, ne kete menyre, eshte eleminuar mundesia e korrupsionit. Vleresim maksimal moren ne lidhje me kete ceshtje, SPA Korçe me drejtuese Albina Pepo, SPA Tirane qytet me drejtues Haxhi Meçuli, SPA Tirana rreth, me drejtues Shaban Duka, SPA Lushje me drejtues Luan Zonja, SPA Gramsh me drejtues Hyqmet Kaçaniku, si edhe drejtuesit e rinj qe riorganizuan sindikatat ne rrethet e tyre: ne Durres;Alfred Doraci, ne Mat; Arben Kola, ne Pogradec; Gjergji Treska, ne Lezhe; Pjeter Prenga, ne Bulqize; Gani Keta etj. Por, gjithashtu, u theksua si e pajustifikueshme, puna e pamjaftueshme ne lidhje me funksionimin organizativ te seksioneve ne rrethet Berat, Gjirokaster, Laç, Peqin, Skrapar, Malesi e Madhe dhe Puke.

Gjate vitit 2009 iu ngarkua si detyre sektorit te organizimit te SPASH-it, funksionimi i SPA ne rrethet Kukes, Permet, Kavaje, Librazhd, Sarande e Has.

Gjithe kjo veprimtari e SPASH qe u diskutua ne kete mbledhje do te marre force vendimore ne mbledhjen e Keshillit Kombetar te SPASH qe do te zhvillohet ne daten 6 shkurt 2009.

Po keshtu, SPASH, si pjese perberese e BSPSH, do te marre pjese aktive ne te gjitha aktivitetet dhe veprimtarite qe do te zhvillohen nga BSPSH gjate vitit 2009.

Nevrus Kaptelli
Departamenti i Organizimit dhe i Mardhenieve me Publikun ne SPASH

Takim me drejtues lokale te Seksionit te FSASH per Tiranen Rreth

Riorganizimi i Seksionit sindikal te FSASH-it per Tiranen Rreth ishte ne qender te diskutimeve qe u bene ne Takimin qe u organizua nga ana e Kryesise se FSASH-it me drejtues te keshillave sindikale te shkollave, kryesisht nga zona e Kamzes dhe Bathores.

Pjesemarresit ne Takim informuan mbi situaten ne sindikatat e shkollave perkatese, problemet me te cilat ndeshen mesuesit ne keto shkolla dhe nevojen per permiresimin e punes ne nivel seksioni, me qellim qe te ndihmohen organizatat sindikale ne disa shkolla ku ka me shume veshtiresi organizimi dhe strukturat sindikale nuk funksionojne sic duhet.

Ne takim u evidentua puna e mire qe eshte duke u bere nga sindikalistet Derall Tota, Marie Frroku dhe Bjeshke Aliaj, ne shkollat 9-vjecare te Bathores, gje qe do te shtrihet ne ditet qe vijne e dhe ne Shkollen e Mesme te kesaj zone. Po keshtu, situate e mire paraqitet edhe ne shkollat e Kamzes se Re dhe Valiasit, ku punojne me perkushtim mesuesit sindikaliste Mersin Terpo e Tafil Ibro, te cilet shprehen gatishmerine per ta vazhduar kete pune edhe ne shkollat e tjera te kesaj zone e me gjere.

Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushi, pasi vleresoi punen e bere nga pjesemarresit ne takim, kerkoi angazhimin e drejtuesve lokale te ketij Seksioni, sidomos nga shkollat e kesaj zone per zgjerimin e anetaresise ne shkollat perkatese dhe per perfshirjen edhe te shume shkollave te tjera ne aktivitetet per ristrukturimin e Seksionit sindikal te Tiranes Rreth. Ai e vuri theksin, gjithashtu, tek domosdoshmeria e vendosjes se kontakteve te drejtperdrejta me mesuesit anetare te FSASH-it per njohjen e problemeve me te cilat ata perballen, si edhe per trajtimin e zgjidhjen e ketyre problemeve, per sigurimin e me shume sherbimeve per anetaret e sindikates dhe per motivimin me te mire te mesuesve sindikaliste e te atyre qe kane rezultate te larta ne mesimdhenie dhe ne punen individuale me nxenesit qe paraqesin probleme ne vijim e ne pervetesimin e lendeve mesimore.

Ne Takim u vu theksi, gjithashtu, tek domosdoshmeria e punes kolegjiale te Kryesise se keti Seksioni, duke grumbulluar rreth vetes sindikaliste te perkushtuar e te gatshem te marrin persiper e te ndjekin per zbatim detyra konkrete, sipas programit dhe objektivave te Federates.

Ne takim u be nje ndarje e punes dhe detyrave konkrete per nje periudhe njemujore, pas se ciles do te organizohet nje Takim tjeter per te analizuar ecurine e kesaj pune dhe per te percaktuar objektiva te reja ne vijim te veprimtarive per fuqizimin e sindikatave dhe riorganizimin e Seksionit sindikal te Tiranes Rreth.

Shaban VRANA

Organizimi "Orës së lirë" kërkon pune krijuese nga çdo mësues

(Përvojë nga shkolla "Hoteleri Turizëm", Tiranë)

Shkolla "Hoteleri Turizem" në Tiranë i kushton nje kujdes te vecantë organizimit të orëve të lira, në funksion të edukimit të nxënësve, duke mbajtur parasysh se një orë e lirë është zbavitje, dëfrim, argëtim, por është edhe edukim.

Një nga shembujt e mirë në këtë drejtim është organizimi i një ore të lirë në lëndën e Higjienes me temë: "Të mbrojmë mjedisin nëpermjet edukimit"

Per organizimin e këtij aktiviteti, morëm shkas nga konkurimi midis shkollave të mesme të qytetit të Tiranës, të organizuar nga Fondacioni "Don Bosko", në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore të qytetit dhe Ministrinë e Mjedisit.

Në këtë konkurim, Shkolla jonë u paraqit me 30 punime në 3 fushat e konkurimit: Logo, Sllogan dhe Foto (ose kartelon), duke u vlerësuar me Çmim të Parë për "Kartelonin më të mirë mjedisor", i cili u shpërblye me një biçikletë. Fituesja e këtij Çmimi ishte nxënësja Ardita SEVO e vitit te V/b.

Me cilësinë e përgjegjëses së Grupit Ekologjik, si dhe mësuese në lëndët e "Higjenës"dhe të "Kimisë", unë e përzgjodha këtë temë në orën e lirë në lëndën e "Higjenës", duke parë edhe interesimin e nxënësve. Sigurisht që nuk ishte e lehtë të organizoje një orë të lirë në një mjedis shkollor të

Vijon në faqen 10

Vijon nga faqja 9

mbingarkuar, ku mësojnë 2 turne nxënësish njëkohësisht, konkretisht në turnin e parë zhvillon mësimet Shkolla "Karl Gega" dhe mbasdite, në turnin e dytë, shkolla "Hoteleri-Turizëm". Kushtet nuk ishin të përshtatshme, sidomos për të realizuar anën artistike të programit të orës së lirë. Çdo ditë na duhej të boshatisnim klasën për të bërë prova të materialit muzikor, koreografik, dhe pastaj të përgatisnim përsëri klasën për zhvillimin e orës së mësimit të radhës.

mundësinë e zbukurimit të saj (dekoracionit), si vendosja e tullumbaceve, luleve të ndryshme, ngjitja në mure e posterave të nxënësve etj.

Ora e lirë u zhvillua në formën e një mini-konkursi brenda grupit ekologjik apo viteve të para dhe të dyta të shkollës sonë, ku nga 30 punimet e paraqitura, u përzgjodhën për konkurim 10 më të mirët, ku, me pas, çdo nxënës paraqiti punimet e tij përpara një Jurie të ngritur posaçërisht për këtë veprimtari dhe të përbërë nga Nën/Drejtorët dhe ata shoqëroheshin nga një kolazh muzikor me këngë e koreografi të luajtur nga vetë nxënësit konkurues, duke shfaqur kështu talentin e tyre edhe në një fushë tjetër. Në këtë mënyrë, prezantimi i punimeve të tyre u bë më tërheqës e spektakolar.

Në fund, Juria nderoi me 3 çmime të para për tre fushat: Logo-Sllogan-Foto (Kartelon), ku çmimin e madh e morën dy motrat Dajana dhe Jasmina Meça, nxënëse përkatësisht në vitin e I/a dhe II/a, si paraqitje më aktuale lidhur me edukimin mjedisor.





Jo pa qëllim i përmenda këto vështirësi, mbasi dua të nxjerr në pah kontributin dhe bashkëpunimin e Drejtorisë së Shkollës dhe nën/drejtoreshave, të cilat më dhanë një mbështetje të fuqishme dhe admiruese për arritjen e qëllimit të kësaj ore argëtuese, dëfryese dhe edukative, në mënyrë që nxënësit të mos dilnin të zhgënjyer.

Në mënyrë të veçantë dua të falenderoj drejtorin e Shkollës së Mesme "Karl Gega", Z. Bashkim, i cili na vuri në dispozicion klasën, me qëllimin e mirë të realizimit me sukses të kësaj veprimtarie, gjë që krijoi anëtarë të Bordit të shkollës.

Secili nxënës, gjatë prezantimit jepte shpjegime rreth punës së kryer, duke evidentuar anën edukative të saj, si të mbrojmë mjedisin nëpërmjet edukimit.

Të dhjetë krijimet e tyre paraqesnin skica, piktura të ndryshme, poezi, sllogane, foto dhe mesazhe, të cilat komentoheshin dhe transmetoheshin tek të gjithë pjesmarrësit e tjerë, si formë zinxhiri, duke kaluar, nga individi, në familje, bashkësi dhe në mbarë qytetin.

Gjatë gjithë kohës që nxënësit ekspozonin punimet e tyre, në klasë

Gjithashtu, të gjthë nxënësit konkurues të dhjetë punimeve të përzgjedhura, u shpërblyen me dhurata modeste, të sponosizuara nga vetë unë, si mësuesja e Grupit Ekologjik të Shkollës.

Në fund të konkurimit, të gjitha shkollave të mesme iu dërguam një mesazh mjedisor me sloganin: "Një botë të re s'mund ta krijojmë, por atë që kemi mund ta mbrojmë".

Fatbardha DOBI
Përgjegjëse e Grupit Ekologjik të Shkollës së Mesme "Hoteleri-Turizëm",
Kryetare e KS të Shkollës.

Tregues të trajnimit të personelit arsimor gjate vitit 2008

Albana Markja
Përgjegjëse e Sektorit të Trajnimit IKT

Gjatë vitit 2008 reformimi i sistemit arsimor të tërësi ka përfshirë, pa dyshim, edhe reformimin e sistemit të zhvillimit profesional të mësuesve e drejtuesve. Një reforme do të konsiderohej e dështuar pa përgatitjen e duhur të kapaciteteve njerëzore lidhur me risitë dhe përgjegjësitë e reja që sjell reforma. Në këtë kuadër, fusha e trajnimit të mësuesve dhe drejtuesve ka zënë një vend të rëndësishëm dhe një peshë të konsiderueshme në morinë e projekteve dhe programeve të iniciuara dhe zhvilluara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit (IKT).

Programet kryesore në fushën e trajnimit të personelit arsimor janë iniciuar dhe zhvilluar nga Drejtoria e Trajnimit në Institutin e Kurrikulës dhe Trajnimit. Kjo drejtori, në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR) dhe Zyrat Arsimore (ZA) të vendit, inicoi dhe zbatoi një numër të madh programesh trajnuese gjatë vitit.

Synimi kryesor i veprimtarive të kryera ka qene:

• Mbështetja e reformës arsimore në arsimin parauniversitar përmes trajnimeve të personelit arsimor.

• Trajnimi i sa më shumë specialistëve, drejtuesve dhe mësuesve për Udhëzimet e dala nga MASH në periudhën 2007-2008.

Programet e zhvilluara dhe të zbatuara gjatë vitit mund të ndahen në dy grupe të mëdha lidhur me mbështetjen financiare të tyre. Duhet nënvizuar fakti se, megjithëse,synimi i përgjithshëm i programeve trajnuese të personelit arsimor ka qenë i përbashkët, ato mund të ndahen lidhur me mbështetjen financiare të tyre. Një pjesë e rëndësishme e programeve është mbështetur nga programi "Cilësi dhe Barazi në Arsim – CBA", i cili ka mbështetur fuqishëm programet më të rëndësishme që lidhen drejtpërdrejtë me risitë që sjell reforma arsimore. Një pjesë tjetër e rëndësishme e programeve është mbështetur nga buxheti i shtetit, i cili është fokusuar më shumë në mbështetjen e programeve në vazhdimësi nga vitet paraardhëse si dhe një numër të konsiderueshëm botimesh në ndihmë të mësuesve dhe drejtuesve të arsimit.

Programet e mbështetura nga programi "Cilësi dhe Barazi në Arsim – CBA janë:

• Trajnimi i mësuesve dhe drejtuesve të arsimit bazë dhe të mesëm lidhur me reformën arsimore. Në kuadrin e këtij programi janë përgatitur një sërë modulesh dhe janë trajnuar një numër i konsiderueshëm personash lidhur me Udhëzimet e MASh për: planin vjetor të shkollës, objektivat e arritjeve të nxënësve, zhvillimin e orëve të lira në shkollë, bordin e shkollës, manualin e drejtuesit (përgatitur nga IKT) dhe treguesit e shkollës së suksesshme. Realizimi i këtij programi ka kërkuar një angazhim shumë të madh kohor dhe energjish duke sjellë si rezultat një numër të konsiderueshëm personash të trajnuar.

• Përvijimi i reformës së zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve. Në kuadrin e këtij programi, për vitin 2008 është realizuar prodhimi i dokumenteve shumë të rëndësishëm për këtë reformë, siç janë: Standardet e përgjithshme të mësuesit, Standardet e drejtuesit të shkollës dhe Standardet e trajnerit në arsim. Këto dokumente draft, presin miratimin nga MASH, në mënyrë që për vitin e ardhshëm të fillohet trajnimi lidhur me ta. Të tri këto dokumente përbëjnë një bazament të rëndësishëm për të siguruar efektivitetin e reformës arsimore.

• Hartimi i manualit të drejtuesit të shkollës (5000 kopje). Për t'i ardhur në ndihmë reformimit të rolit dhe përgjegjësive të drejtuesit të shkollës, në kuadrin e reformës, është përgatitur një botim i cili përcjell, përmes moduleve, problematikat më të rëndësishme lidhur me drejtimin e shkollës. Në këtë kuadër janë trajnuar të gjithë drejtuesit e shkollave ë Shqipëri.

• Trajnimi i inspektorëve qendrorë dhe lokalë për reformën arsimore. Suksesi i reformës arsimore varet në një masë të konsiderueshme nga roli dhe profesionalizmi i inspektimit të shkollës. Në këtë këndvështrim, gjatë këtij viti i është kushtuar kujdes trajnimit të inspektorëve në DAR lidhur me mënyrën dhe format e inspektimit të aspekteve të reja që sjell reforma në shkollë. Në këtë kuadër janë trajnuar të gjithë inspektorët e vendit.

Programe të mbështetura nga buxheti i shtetit janë:

• Trajnimi i mësuesve të arsimit bazë për programet e reja të klasës së pestë dhe nëntë. Çdo vit, drejtoria e IKT, ka paraprirë futjen e kurrikulave të reja në arsimin 9 vjeçar, me trajnime të përfaqësuesve

Vijon në faqen 12

Vijon nga faqja 11

të DAR dhe ZA për të gjitha lëndët. Kështu, në gusht – shtator të këtij viti u trajnuan 480 përfaqësues sipas lëndëve përkatëse.

• Formimi i trajnerëve. Drejtoria e IKT inicio për herë të parë një kurs formimi për trajnerë në arsim. Pjesëmarrësit në këtë kurs u përzgjodhën përmes aplikimit të shpallur. Kursi zgjati 12 ditë të plota trajnimi.

• Hartimi i programeve orientuese për zhvillimin profesional të mësuesve të arsimit parauniversitar. Këtu bëhet fjalë për programe të ndryshme në funksion të kualifikimit dhe trajnimit të mësuesve që IKT i sugjeron DAR dhe ZA , për të ndërtuar planifikimit e tyre vjetore lidhur me trajnimin dhe kualifikimin e mësuesve.

qenë i hapur dhe ka ofruar mbështetjen dhe ndihmën e plotë profesionale për të gjithë institucionet e tjera ndërshtetërore dhe jofitimprurëse që investojnë në fushën e reformimit të shkollës dhe arsimiit në përgjithësi. Ndër këto institucionë mund të përmenden Unicef, REC, Unesco, Save the children, etj. Edhe Sindikata e Arsimit kane dhene një kontribut te rëndësishë në fushën e trajnimit. IKT vlerëson përpjekjet e sindikatave të arsimit lidhur me trajnimin e grupeve të mësuesve e drejtuesve që punojnë me fëmijë të margjinalizuar duke e cilësuar si një nga fushat e rëndësishme të reformës kurrikulare dhe të trajnimit.

Numri i personelit arsimor të trajnuar gjatë vitit 2008

Nr	Titulli i modulit	Lloji i pjesëmarrësve	N. pjesm
1.	OAN	Mësues	5400
		Trajner lokal	600
2.	Plani vjetor	Drejtorë shkollash	1714
		Nëndrejtorë	1158
		Specialistë DAR/ZA	98
3.	Orët e lira	K/ekipesh kurrik & mësues	1465
		Specialistë DAR/ZA	85
		Drejtues të tjerë	1345
4.	Bordi i shkollës	Kryetarë bordesh	924
		Specialistë DAR/ZA	51
5.	Manuali i drejtorit	Drejtues shkollash	3102
		Specialistë DAR/ZA	104
6.	Inspektorë lokalë (Udhëzimet e MASH)	Inspektorë lokalë	110
7.	Inspektorë lokalë (Task force)	Inspektorë lokalë	110
8.	Kurrikula e re (5 &9)	Specialistë DAR/ZA & mësues	480
9.	Formimi i trajnerëve	Specialistë, drejtues, mësues	76

Për realizimin e synimeve të vëna si dhe për t'i ardhur në ndihmë sa më shumë shkollës, gjatë këtij viti, IKT ka

Procesi i realizimit dhe vlerësimit të trajnimeve

Kujdes i veçantë në realizimin e programeve të mësipërme iu kushtua procesit nëpër të cilin do të përcilleshin programet. Ky proces u realizua duke u udhëhequr nga parimi "Menaxhimi në sajë të përformancës". Për secilin program, procesi ka kaluar përgjithësisht në këto hapa:

1. Për secilin modul u përgatitën kapacitete lokalë. Ata ishin kryesisht përfaqësues të zyrave të DAR dhe ZA-ve. Ato kanë luajtur rolin e trajnerëve lokalë për module të caktuar.

2. Përgatitja e trajnerëve lokalë u bë përmes sistemit modular dhe vlerësimit të tyre. Modulet u përgatitën nga specialistët e MASH dhe IKT si dhe nga hartuesit e Udhëzimeve të dala nga Ministria. Në fund të çdo moduli u bë vlerësimi i pjesëmarrësve.

3. Kapacitetet lokale (trajnerë lokalë) trajnuan drejtues apo mësues në DAR & ZA të cilët u testuan në fund të procesit. Kjo do të thotë se trajnimi i marrë në nivel qëndror u përcoll te mësuesit dhe drejtuesit e çdo qarku apo rrethi.

4. Trajnerët lokalë dokumentuan në IKT të gjithë trajnimet lokale. Çdo seancë trajnimi e zhvilluar nga trajnerët lokalë u dokumentua sipas kërkesave të paracaktuara.

5. Nga IKT u bë certifikimi i tyre me anë të sistemit të krediteve. Kreditet janë parë si nxitës në karrierë. Çertifikatat e shpërndara janë në tre nivele: trajner i trajnerëve, trajnerë lokalë dhe pjesëmarrës në trajnim.

Vecori të procesit të trajnimeve

• Siç mund të kuptohet nga parashrimi i mësipërm, ky proces është "Menaxhimi në sajë të përformancës". Kjo ka qenë një pikë

shumë e fortë dhe e rëndësishme për të siguruar efektivitetin e trajnimeve.

- Për herë të parë përdoret sistemi i krediteve ne fushën e trajnimeve. Nga Drejtoria e trajnimit, tashmë është arritur në një konsensus për të bërë vlerësimin e pjesëmarrësve në sesione trajnuese përmes një sistemi kreditesh. Kjo shihet si një motiv i rëndësishëm për të përmirësuar cilësinë e sistemit të kualifikimit dhe trajnimit.
- Procesi është monitoruar hap pas hapi. Specialistë të trajnimit dhe koordinatorë të programeve kanë kryer në masë të konsiderueshme monitorimin e trajnimeve lokale.
- Nr i të trajnuarve është më i madh se statistika e dhënë. Rezulton se ka shumë mësues të trajnuar jashtë programevet të IKT. Këto trajnime janë kryer nga inisiativat e DAR dhe Za për të mbuluar sa më shumë nevojat e mësuesve.
- Specialistët lokalë & drejtuesit janë numri më i madh i të trajnuarve. Kjo është bërë duke qenë se ato janë menaxhuesit dhe organizuesit kryesor të trajnimit në nivel lokal.

Vazhdimësia ...

Disa nga synimet e rëndësishme të IKT në fushën e trajnimit për periudhën në vazhdim janë:

- Të vazhdojë zgjerimi dhe hartimi i moduleve dhe trajnimet (sidomos orët e lira dhe OAN)
- Përvojat më të mira të grumbulluara do të pasqyrohen përmes faqes së internetit të IKT – www.ikt.edu.al
- Nxitja e hapjes së tregut të ofruesve të trajnimit. Kjo mendojmë se do të arrihet duke ngritur Komitetin e Akreditimit, etj.

NJË PËRVJETOR I SHËNUAR I GJIMNAZIT TË TIRANËS

1. Pak radhë nga historiku

Koha ecen e ajo lë gjurmë të pashlyera në jetën e njerëzve, por dhe të institucioneve tona arsimore. Ja, si pa u kuptuar kaluan edhe 73 vjet nga dita e çeljes së njërës ndër vatrat më të njohura të diturisë e atdhetarizmit në vendin tonë, Gjimnazit të Tiranës. Kur kthejmë kokën prapa, njihemi dhe me rrugën e vështirë, nëpër të cilën ka kaluar ai, por dhe me ndihmesën e madhe që ka dhënë ndër vite për mësimin dhe edukimin e brezave të tërë të nxënësve shqiptarë.



Vitet ’20 të shekullit të kaluar, në historikun e shkollave tona po shënoheshin arritje të reja. Duke marrë parasysh nevojat e zgjerimit të arsimit të mesëm në Tiranë, sidomos gjatë vitit 1924, u dendësuan kërkesat e rinisë dhe të masave popullore për hapjen e një shkolle të mesme të përgjithshme ose të një gjimnazi, siç quhej në atë kohë. Gjithashtu, kjo ishte dhe dëshirë e flaktë e mësuesve atdhetarë e përparimtarë, si Sali Çeka, Qamil Bala, Ahmet Gashi e të tjerë. Më parë në kryeqytet kishte një shkollë private (qershor 1924). Më në fund, u arrit që ajo shkollë e mesme të çelte dyert më 3 dhjetor 1925, duke nisur kështu viti i ri arsimor. Në fillim kishte vetëm 25 nxënës, me 4 profesorë e 2 mësues. Drejtor u caktua intelektuali i njohur i asaj kohe, Mihal Sharko (1887-1957).

Kjo ngjarje u mirëprit nga forcat demokratike dhe intelektualët përparimtarë të kohës, nga brezi i ri i etur për dituri e kulturë. Pra, ajo shënonte një hap të rëndësishëm përpara për zgjerimin dhe konsolidimin e arsimit të mesëm në Shqipëri, pas çeljes së Liceut Kombëtar të Korçës (më 25 tetor 1917), Shkollës së Mesme Teknike në Tiranë (më 1921) dhe Gjimnazit të Shtetit në Shkodër (më 5 tetor1922). E kjo vepër atdhetare do të pasohej më vonë dhe me çeljen e shkollave të tjera, në qytete e fshatra të vendit tonë.

Që në fillim, kolektivi i mësuesve dhe i nxënësve të Gjimnazit të Tiranës, këtij institucioni të mesëm arsimor, u ndesh me pengesa e vështirësi të shumta dhe u përball me frymën antikombëtare të disa elementëve regresivë të kohës. Mësimi u nis vetëm në degën klasike dhe kjo vazhdoi deri në vitin arsimor 1931-

Vijon në faqen 14

Vijon nga faqja 13

1932. Numri i mësuesve e nxënësve ishte i vogël, në krahasim me shkollat e tjera te mesme në vendin tonë. Kishte mungesa për libra, fletore e lapsa , mjete mësimore e orendi shkollore. Gjithashtu, në vitet 1928-1930, në të njëjtin lokal dhe po me ata mësues, ishin dhe nxënësit e shkollës ushtarake të Tiranës. Në atë periudhë, ndikoi per keq për mbarëvajtjen e punëve dhe ndërrimi i 15 drejtorëve, një në çdo vit. Ndërsa në vitin arsimor 1938-1939 ndërtesa e Gjimnazit u vendos në lokalet e ish-kazermës "Skenderbeg". Aty shërbyen 22 mësues. (Vepra "Historia e Arsimit dhe e Mendimit Pedagogjik Shqiptar", Tiranë, 2003, faqe 474).

Por me përpjekjet e parreshtura të drejtuesve dhe të kolektivit pedagogjik, shpejt u kaluan veshtirësitë e para dhe kjo shkollë e mesme bëri emër të mirë ndërmjet shkollave të kohes, kur e zhvilloi veprimtarinë e saj. Kështu, në fillim të viteve '30 u arrit që të shtohej numri i nxënësve e i mësuesve, si dhe i konviktorëve të tij, të ardhur nga krahina të tjera të Shqipërisë.

Me pushtimin fashist të vendit, u vërejt rritja e pakënaqësisë dhe e frymës atdhetare e liridashëse, në ketë vatër të ndezur kombëtare. Fillimi i luftës për liri, bëri që të dilnin në mal afër 400 nxënës të këtij Gjimnazi dhe, prej tyre, 75 dhanë jetën për lirinë dhe idealet demokratike. Nga ata, 13 janë nderuar me titullin e lartë "Hero i Popullit". (Sh.Osmani, "Fjalori i pedagogjisë", Tiranë, 1983, faqe 242). Ndër nxënësit më të mirë të tij ishin dhe Vasil Shanto, Ali Demi, Asim Zeneli, Manush Alimani e të tjerë dëshmorë të Atdheut. Breza të tërë mësuesish nuk kursyen energjitë e tyre mendore as fizike për mësimin dhe edukimin e nxënësve të tyre të dashur. Prandaj ata kanë mbetur kurdoherë të paharruar jo vetëm për nxënësit e tyre, por dhe për kolegët, prindërit e mbarë popullin. Ndër ta, përmendim me nderim edhe A.Xhuvanin, E.Çabejn, A.Budën, Gj.Cancon, A.Gashin, A.Zajmin, Q.Balën, G. Meksin, A.Buzën, M.Karajanin, N.Bulkën, Z.Rexhën e shumë të tjerë.

Në vitet e Luftës II Botërore, si rrjedhojë e vështirësive që i dolën përpara, Gjimnazi i Tiranës e ndërpreu për disa kohë jetën dhe veprimtarinë e tij. Ndërsa mbas çlirimit ai e vijoi punën e mëparshme, tanimë në kushte të reja. Në vitin shkollor 1947-1948 ai mori emrin e ish-nxënësit Qemal Stafa, "Heroi i Popullit", të cilin e ka edhe sot. Hap pas hapi, u shtua numri i nxënësve dhe i mësuesve të kualifikuar, u plotësuan kushtet për tekste, me orendi e mjete mësimore etj. Si konkretizim të kësaj, po përmendim ndonjë fakt. Në vitin arsimor 1965-1966, aty numëroheshin rreth 1.200 nxënës dhe 50 mësues. Ndërsa në vitin arsimor 2005-2006 kishte 1.400 nxënës (në 33 klasa) dhe 50 mësues.

2. Vazhdimësia…

E kam vizituar disa herë këtë vatër drite e diturie në kryeqytet. Dhe gjithnjë kam ndierë aty pulsin e gjallë të jetës, përkushtimin e kolektivit mësues-nxënës për të arritur të mirën më të mundshme. Ja, shfletoj bllokun e shënimeve të provimeve të maturantëve, më 2003. Ndër të tjera, aty lexoj dhe këto radhë:

"Kënaqësinë për arritjet vjetore dhe për provimet, zv.drejtoresha e shkollës, Nora Malaj, i shpreh, duke thënë:- Maturantët e gjashtë klasave po e dëshmojnë më së miri përgatitjen dhe formimin e tyre katërvjeçar në provimet e pjekurisë. Ata trajtuan sipas dëshirës, një nga tri temat e hartimit. Vumë re se më e pëlqyera, më e kapshmja dhe më interesantja për ta ishte tema e tretë: "Kjo këmbanë bie edhe për ty!" Atë e trajtuan afër 60% e nxënësve dhe në të patën mundësi të shprehnin ndejnjat e mendimet, pjekurinë dhe formimin e tyre të përgjithshëm. Në temat e zhvilluara ata trajtuan shqetësimet e moshës dhe ato sociale të kohës, duke u shprehur se gjëja më e çumar është jeta e njeriut dhe ajo duhet përdorur me dinjitet".

Kur vështron udhën e gjatë të këtij Gjimnazi, mëson se prej tij kanë dalë qindra nxënës, të cilët nuk kanë kursyer dijet as djersën e tyre për ndërtimin dhe përparimin e Atdheut. Në mes tyre, dhjetëra janë profesorë e akademikë, shkencëtarë, shkrimtarë e artistë, që janë nderuar me tituj të lartë. Nga këta, 18 janë "Mësues i Popullit" e 12 "Mësues i merituar" dhe disa të tjerë "Artist i Popullit" e "Piktor i Popullit",etj.

Sidomos pas viteve '90 të vendosjes së demokracisë në Shqipëri, Gjimnazi i Tiranës vazhdon të mbajë një emër të mirë e të merituar jo vetëm ndërmjet shkollave të mesme të kryeqytetit, por dhe në shkallë vendi. Kështu, është përfaqësuar me dinjitet edhe në të gjitha veprimtaritë e zhvilluara. Ai ka luajtur dhe luan një rol me shumë rëndësi në arsimimin e brezit të ri, duke u rrënjosur atyre njohuri të përgjithshme dhe duke i përgatitur për të vazhduar shkollat e larta, në profile të ndryshme.

Kolektivi i mësuesve dhe i nxënësve të tij, ashtu si i shkollave të tjera të mesme e 9-vjeçare të kryeqytetit dhe në mbarë vendin tonë, në këtë viti arsimor po bën përpjekje të parreshtura për një mësim dhe edukim bashkëkohor, me orientim perëndimor. Një rol me rëndëasi kanë luajtur e luajnë aty edhe sindikatat e mësuesve, duke qenë partnerë të rëndësishëm të drejtuesve të shkollës dhe organizmave të tjera, me synimin e mirë për rritjen e treguesve në procesin e mësimit dhe të edukimit të nxënësve, në shkollë e jashtë saj.

Në këtë përvjetor të shënuar të Gjimnazit të Tiranës dhe në pragun e festave tradicionale të fundvitit, të gjithë ne urojmë që kjo shkollë e përmendur për mirë të shënojë gjithnjë arritje të reja.

Prof.as.Dr. MURAT GECAJ

Të reja shkencore

LAPTOPËT MË TË MIRË TË VITIT 2008

Gjate viteve të kaluara kemi parë të hyjnë në skenë laptopë nga më të ndryshmit, të cilët kanë zëvendësuar ndjeshëm kompiuterat e tavolinës. Disa nga më intersantët e vitit 2008 janë:

Samsung X460



Samsungu i ka munguar shumë tregut të laptopëve dhe, me daljen në treg të X460, mund të themi që vërtet na ka munguar. Ky laptop, shumë i hollë, me ekran 14.1 polsh mund të përdoret për qëllime të ndryshme. Kjo reflektohet edhe tek çmimi prej $1,699. Me këtë çmim, ju blini 2.26-GHz Intel Core 2 Duo P8400 CPU, 3GB RAM dhe një procesor grafik të pranueshëm.

Sony VAIO, VGN-Z598U

Çmimi i këtij laptopi fillon me $1,499, por ai që ne do të përshkruajmë arrin në shifrën shokuese prej $4,450. Këtë çmim e justifikojnë një sërë draiverash prej 128GB, 2.53-GHz Intel Core 2 Duo P9500 CPU, 4GB RAM dhe një procesor grafik nVidia GeForce 9300M GS. Pesha e tij është vetëm 1.5 kg (1.9 kg me bateri).



Apple MacBook Air

MacBook Air është një laptop shumë i hollë që mund të vendoset në çdo hapsirë. Si më çdo gjë tjetër



që Apple krijon, pamja e jashtme e Air është fenomenale. Por bukuria e tij shkon më thellë se aparenca. Përveç faktit që është i pajisur me 1.6-GHz Intel Core 2 Duo L7500 (relativisht i fuqishëm për një laptop), Air ka një ekran 13.3 polsh, 1280-800 pixel, një tastjerë të gjerë në të cilën nuk do të keni frikë se shtypni tastin e gabuar. I mungon drive optik dhe, nëse doni të lidheni me një rrjet duke përdorur Ethernet, duhet të blini një adaptor plus që kushton $29 USB. Çmimi fillestar është $1,700.

HP Mini 1000

Mini 1000 është laptopi i gjeneratës së dytë të HP i hedhur në treg dhe ka një sërë avantazhesh. Mini 1000



ka të instaluar Windows XP dhe është i pajisur me një procesor Intel 1.6-GHz Atom, 1GB RAM dh 60GB PATA hard drive.

Fatmirësisht tastjera e këtij laptopi është fantastike. Tastet e mëdha duken si të një laptopi me masë normale, ato u përshtaten tërësisht gishtave. Çmimi fillon me $399 dhe për cilësitë që përshkruam shkon deri në $549.

Këshilla praktike

SHTATE GJËRA PËR TË CILAT NUK DUHET TË JEPNI SHUMË INFORMACION NË PUNË

1. Historinë tuaj mjekësore

Spitalet dhe departamenti i burimeve njerëzore e kanë të ndaluar me ligj dhënien e informacioneve mbi gjendjen tuaj mjekësore. Njerëzit kanë tendencën të ndyrshojnë sjellje, kur zbulojnë diçka në lidhje me shëndetin tuaj. Mund t'ju trajtojnë si fëmijë, ose t'ju mbajnë larg.

2. Informacione konfidenciale mbi punën

E dëgjove kush do pushohet nga puna? Ti, sepse ti nuk mund t'i mbash informacionet sekrete për vete.

3. Plane për t'u larguar nga puna

Kur jeni duke kërkuar një punë të re, kujdesuni që kolegët tuaj të mos marrin vesh gjë. Informacioni mund të arrijë deri te shefi. Kjo mund të sjellë si pasojë largimin tuaj para afatit që ju dëshironi.

4. Çështjet e zemrës

Reputacioni juaj do të dëmtohej nëse një ditë shkoni në zyrë duke qarë, sepse sapo u ndatë nga partneri dhe pas një jave vini duke kërcyer, sepse keni njohur dashurinë e jetës suaj. Njerëzit mund të mos jenë në gjendje të ndajnë jetën tuaj private nga ajo profesionale.

5. Politikë

Duhet ta kini vënë re se si dalin jashtë kontrollit bisedat e politikës, kur diskutoni me familjarët ose miqtë tuaj. Doni vërtet të keni nga këto lloj problemesh në punë? Kini parasysh që familja jua është "e detyruar" t'ju dojë ndërsa kolegët jo.

6. Informacione për pagën

Pagesa lidhet me vlerën dhe, kur kjo merret vesh, mund të bëhen spekullime që ju jeni i mbi ose nënpaguar. Pse paguheni kaq shumë, kur dikush tjetër, me të njëjtat kualifikime, paguahet më pak? Evitoni thashethemet dhe mbajeni këtë informacion për vete.

7. Konsiderime per Fenë

Eshtë një çeshtje vetjake, infomacionet mbi të cilën nuk ju shtojnë ndonjë vlerë në mardhënie me punëdhënsin.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

TRIBUNA SINDIKALE

